

Behxhet Dibrani¹

DIPLOMACIA NDËRKOMBËTARE DHE KONFERENCA E RAMBUJESË 1998-1999

ABSTRACT

The internationalization of the Kosovo issue in the international arena had been quite a process difficult, which was influenced by different actors. First of all, it should be noted that since In the 1990s, the peaceful policy followed by the albanians led by the historical leader Ibrahim In its beginnings, Rugova was seen as necessary. This necessity was described as right. until 1995, when the Dayton Conference was held. After holding the Conference of At Dayton, the abanians felt excluded and their case was not discussed at all Conference, this was thought to be a clear order for the Albanians from the international factor. Even in this conference there were diplomats who responded to the Albanians as to why it was not discussed their issue at the Rambuje Conference, he had said that they had been invited to Rambuje those who had fought. So it was necessary to think about the radicalization of the movement and its actions. Albanians in relation to the violence and genocide that was continuing to happen to them in Kosovo by the Milosevic regime. Thus, after the massacres that began to take place in Qireza and Likošan and Prekaz, it was clearly seen that only with an armed war, maybe the Albanians could be dealt with higher levels of international diplomacy and could become part of the Conferences international like that of Rambuje. Rambuje was rightly described as the highest level of internationalization of the Kosovo issue, this also forgives the liberation war of the KLA that they had albanians started. So, without this war, a conference of such a level would hardly be organized international and that the Kosovo issue would be treated so seriously by the Community International. Therefore, I think that the Rambouillet Conference was the beginning of a new chapter for Kosovo and the albanians, a chapter which will culminate with the liberation of Kosovo from Serbia and its independence in 2008.

Key words: Kosovo, Rambuje Conference, Diplomacy.

ABSTRAKT

Ndërkombëtarizimi i çështjes së Kosovës në arenën ndërkombëtare kishte qenë një proces mjaftë i vështirë, në të cilën kishin ndikuar akterë nga më të ndryshëm. Sëpari duhet theksuar që nga vitet 1990 politika paqësore e ndjekur nga shqiptarët në krye me liderin historik Ibrahim Rugovën në fillimet e saj ishte parë e domosdoshme. Kjo domosdoshmëri u cilësua si e drejt deri në vitet 1995, kur edhe ishte mbajtur Konferenca e Dejtonit. Pas mbajtjes së Konferencës së Dejtonit shqiptarët ishin ndër të përjashtuar dhe çështja e tyre nuk ishte diskutuar fare në këtë Konferencë, kjo mendohej se ishte një porosi e qartë për shqiptarët nga faktori ndërkombëtar. Bile në këtë konferencë kishte pasur diplomat që si përgjigje ndaj shqiptarëve se pse nuk ishte diskutuar çështja e tyre në Konferencën e Rambujesë, ai kishte thënë që në Rambuje ishin ftuar ata që kishin luftuar. Pra duhej të mendohej për radikalizimin e lëvizjes dhe veprimeve të shqiptarëve në raport me dhunën dhe gjenocidin që po vazhdonte të ndodhte ndaj tyre në Kosovë nga regjimi i Millosheviçit. Kështu pas masakrave që filluan të ndodhnin në Qirezë e Likoshan e Prekaz, shihej qartë që vetëm me luftë të armatosur ndoshta shqiptarët mund të trajtoheshin në nivele më të larta të diplomacisë ndërkombëtare dhe mund të bëheshin pjesë e Konferencave ndërkombëtare si ajo e Rambujesë. Rambuje ishte cilësuar me plotë të drejt si niveli më i lartë i ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës, kjo fal edhe luftës çlirimtare të UÇK-së që kishin filluar shqiptarët. Pra pa këtë luftë vështirë që do të organizohej një konferencë e nivelit të tillë ndërkombëtare dhe që do të trajtohej çështja e Kosovës në mënyrë kaq serioze nga Bashkësia Ndërkombëtare. Prandaj

¹PhD Candidat, Faculty of Phylosophy, Departament of History, University of Prishtina, "Hasan Prishtina", Prishtinë, Republic of Kosovo, Phone:+38344650719, Email: bdibrani@hotmail.com, <https://orcid.org/0009-0006-9301-9596>

mendoj që Konferenca e Rambujesë ishte një fillim i një kapitulli të ri për Kosovën dhe shqiptarët, kapitull i cili do të kulmoj me çlirimin e Kosovës nga Serbia dhe pavarësinë e saj në vitin 2008.

Fjalët kyçe: Kosovë, Rambuje, Konferencë, Diplomaci.

Diplomacia ndërkombëtare 1998-1999 në prag të Konferencës së Rambujesë

Angazhimi sistematik si nga miqtë tanë amerikan dhe evropianë bëri që gradualisht Kosova të dilte nga ajo situata ku cilësohej si çështje e brendshme e Jugosllavisë dhe çështje e të drejtave të njeriut, duke filluar një afirmim të identitetit të vet në nivelin ndërkombëtar¹. Joschka Fischer ministër i jashtëm i Gjermanisë në librin e tij *Vitet Kuq e Gjelbër* shkruante, se pas Dejtonit shqiptarët e kishin kuptuar që pa luftë vështirë do të mund të realizonin aspiratën e tyre për çlirim nga Serbia, mos përfshirjen e tyre në Konferencën e Dejtonit Fischer e kishte konsideruar si gabim shumë të madh². Mos përfshirja e Kosovës mendohej që kishte hapur shtegun edhe për luftëra të reja në Ballkan, pra radha do të vinte në Kosovë pas mbylljes së çështjes me Bosnjën. E vetmja gjë që kishin arritur në Dejton të siguronin rreth Kosovës ishte që të hapej një Zyre Amerikane për Informim, kjo Zyre do të hapej në Prishtinë në vitin 1996³. Hapja e kësaj zyre amerikane në vazhdim do të luante një rol mjaft të madh sidomos në nivelin ndërkombëtar, për shumë procese që po ndodhnin në Kosovë tani opinionin amerikan por edhe ndërkombëtar do të informohej shumë më shpejt dhe drejt. Por duhet potencuar faktin që pas Konferencës së Dejtonit vet administrata e presidentit Klinton e kishte bërë të ditur që Kosova nuk ishte harruar dhe se ajo do të ishte në krye të agjendës amerikane në të ardhmen⁴. Qysh në janar të vitit 1997 në kuadër të prioritetëve të politikës së jashtme amerikane presidenti Klinton kishte deklaruar që heqja e murit të jashtëm të sanksioneve ndaj Serbisë do të ishte i kushtëzuar me zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Pas kësaj situatë edhe Grupi i Kontaktit veq kishte përpiluar deklaratën e parë me 24 shtator 1997 në nivel të ministrave të jashtëm, përmes së cilës shprehej i shqetësuar me situatën në Kosovë, duke iu bërë thirrje edhe Beogradit zyrtar dhe liderëve shqiptarë që të fillojnë dialogun paqësor, njëkohësisht bënte thirrje edhe për implementimin e Marrëveshjes për Arsim⁵. Ndërsa Bashkimi Evropian si fillime diplomatike për zgjidhjen e çështjes së Kosovës në vitin 1998 e kishte emëruar kryeministrin spanjoll Felipe Gonzales, ai do të ishte si ndërmjetës në konfliktin e Kosovës, por me 8 qershor 1998 Jugosllavia ia kishte ndaluar hyrjen, duke bërë që BE-ja të ia kalonte kompetencat te ambasadori amerikan Kristofer Hill, që ky të përpiqej të ndërmjetësonte një dialog eventual

¹ Edita Tahiri, *Konferenca e Rambujesë*, Dukagjini, (Pejë:2001), 21

² Joschka Fischer, *Vitet Kuq dhe Gjelbër*: Politika e Jashtme Gjermane nga Kosova deri më 11 shtator, Koha, (Prishtinë:2007), 100

³ Weley Clark, *Të bësh Luftë Moderne*, Zëri, (Prishtinë:2003), 95

⁴ Edita Tahiri vep. e cit. 38

⁵ Po aty, 40

shqiptaro-serb¹ . Pra shihet qartë se edhe diplomacia ndërkombëtare dhe Bashkimi Evropian i cili veç kishte marrur primatin e zgjidhjes së çështjes së shpërbërjes së Jugosllavisë me mënyra paqësore dhe të bazuara në të drejtën e ruajtjes së sovranitetit dhe rendit ndërkombëtar kishin dështuar duke mos qenë efikas në preventivën e fillimit të konflikteve , si pasojë do kemi fillimin e luftërave të përgjakshme në Ballkan dhe përfundimisht edhe në Kosovë në vitin 1999.

Por evoluimi i çështjes së Kosovës dhe pozitës së saj ndërkombëtare bëri që ajo të fillohej të trajtohej më seriozisht dhe në mënyrë më reale, si problem politik dhe i sigurisë ndërkombëtare . Kjo bëri në vitet në vijim Kosova të zëntë vend edhe në agjendat e Grupit të Kontaktit, të OKB-së, NATO-së² etj. Pas masakrave që vazhdonin të ndodhnin në Kosovë diplomacia ndërkombëtare ende ishte duke vazhduar përpjekjet e saj drejt një zgjidhje në Kosovë. Në këtë aspekt edhe diplomacia ndërkombëtare ishte disi e ndarë, qëndrimet e SHBA-ve dhe ato të evropianëve ndryshonin nga njëra tjetra, evropianët disi ngurrnin të përfshinin UÇK-në bisedime për hir të Beogradit që i cilësonte si “terrorist” , ndërsa amerikanët në krye me diplomatit Holbrook u angazhuan shumë që UÇK-ja të përfshihej në negociata³. Kontakti i disa nga liderët e UÇK-së me disa nga shërbimet perëndimore disi kishte bindur faktorin ndërkombëtar që lufta çlirimtare nuk kishte të bënte asgjë me xhihadizëm dhe terrorizëm⁴ ashtu si kishte propaganduar Beogradi zyrtarë. Qëndrimi i departamentit të shtetit në fillim kishte qenë mjaftë i matur rreth përfaqësuesve të UÇK-së, ata kishin dërguar Holbrookun që të realizonte takime me përfaqësuesit e UÇK-së në diasporë Bardhyl Mahmutin dhe Ramadan Avdiun, takimet kishin zgjatur rreth katër orë amerikanët kishin kërkuar të dinin gjithçka rreth luftës së UÇK-së, pas këtyre kontakteve edhe qëndrimi amerikan dhe mbështetja për luftëtarët kishte filluar të ndryshonte, edhe disa takime në qershor 1998 që Hashim Thaçi kishte pasur me përfaqësuesit e CIA-së kishte arritur të bindte përfaqësuesit e SHBA-ve që ta shtonin bashkëpunimin me UÇK-në⁵. Edhe pse qëndrimi amerikan kishte filluar të ndryshonte në raport me luftën e UÇK-së, anëtarët tjerë brenda Grupit të Kontaktit ende kishin rezervat e tyre dhe u treguan të kujdesshëm. Ndërsa duhet theksuar se austriakët në krye me ambasadorin e tyre në Beograd Wolfgang Petritsch kishin ndikuar në njëfarë mënyre që të ndërronte edhe qëndrimi evropian rreth luftës së UÇK-së, ambasadori Petritsch dhe Albert Rohan si sekretar i përgjithshëm në ministrin e jashtme austriake kishin realizuar edhe takimet e para me Thaçin dhe Kadri Veselin⁶, këto takime kishin

¹ Halim Bajraktari, *Roli dhe Prespektiva Europiane e Kosovës*, punim doktrature, Universiteti i Tiranës, (Tiranë:2014), 14

² Edita Tahiri, vep. e cit. 22

³ Erich Rathfelder, *Kosova: Historia e Një Konflikti*, Artini, (Prishtin:2018), 181

⁴ Jaqcues Baudouin, vep. e cit.119

⁵ Jaqcues Baudouin, vep. e cit.121

⁶ Po aty,123

bërë që qëndrimi evropian të artikulohej gradualisht rreth luftës çlirimtare që po zhvillohej në Kosovë 1998-1999. Masakrat që kishin vazhduar të bëheshin nga regjimi serb në Drenicë ,pothuajse ishin dënuar nga të gjitha institucionet ndërkombëtare, të cilat bënin thirrje për ndaljen e mizorive dhe fillimin e bisedimeve në mes Beogradit dhe përfaqësuesve shqiptar në Kosovë. Këto masakra bënë që me 5 mars të vitit 1998 në Këshillin e NATO-së të bëhej edhe deklarata e parë formale duke iu bërë thirrje autoriteteve të Beogradit të fillonin bisedime liderët e shqiptarëve pa asnjë kusht rreth gjetjes së një zgjidhje politike¹. Joschka Fischer ministër i jashtëm i Gjermanisë mendonte në këtë kohë që do të ishte e papranueshme që politika e spastrimit etnik ndaj shqiptarëve që po ndodhte në Kosovë të lejohej të vazhdonte pa një përgjigje të ashpër të NATO-s. Falë angazhimit të Fischerit kishte arritur që të votohej pozitivisht nga Bundestagu gjerman angazhimi i forcave të armatosura gjermane në përpjekjen e NATO-së për të parandaluar katastrofën humanitare që po ndodhte në Kosovë, ky vendim ishte marrë në Bundestagun gjerman me 12 tetor 1998 dhe u cilësua si historik². Pasi forcat gjermane nuk ishin inkuadruar asnjëherë në ndonjë luftë nga përfundimi i luftës së dytë botërore në vitin 1945 për këtë ishte cilësuar si vendim historik. Mizoria që kishte shfaqur ushtria serbe në Reçak i kishte lënë pa fjalë vëzhguesit e OSBE-së, pasi ata në krye me diplomatën William Walker kishin parë nga afër se çfarë mizorish kishin bërë ushtria jugosllave ndaj civilëve shqiptarë, reportazhet e gazetarëve rreth kësaj masakre edhe njëherë kishin alarmuar opinionin ndërkombëtar³.

Konferenca e Rambujesë 1999 rruga drejt intervenimit të NATO-së në Kosovë

Masakra e Reçakut më 15 janar 1999 kishte alarmuar faktorin ndërkombëtar, ky ishte momenti kur edhe njëherë diplomacia ndërkombëtare do të përpikëj të gjente një zgjidhje, duke u ftuar si shqiptarët po ashtu edhe serbët në një tentativë të fundit për marrëveshje në Rambuje⁴. Kjo konferencë ishte mbajtur nga 6 shkurti deri 23 shkurt të vitit 1999. Punimet e konferencës i kishte hapur presidenti francez Zhak Shirak, ndërsa si ndihmës të tij ishin Robin Cook ministër i jashtëm britanik dhe Yber Vedrin ministri i jashtëm francez. Në fillim ndërmjetësit ua kishin bërë të qartë delegacioneve të dy vendeve që nuk do të kishte diskutime për zbatimin e marrëveshjes, normalisht në fillim të dyja palët kishin bërë deklarata për pozicionet e tyre⁵. Çështje me rëndësi që Grupi i Kontaktit ua kishte bërë me dije të dyja palëve si nga serbët po ashtu edhe nga pala shqiptare ishte se sipas procedurave të konferencës asnjë ndryshim i dokumentit origjinal nuk do të ishte i pranueshëm nëse pala tjetër nuk pajtohej me atë

¹ Edita Tahiri, vep. e cit.42

² Joschka Fischer, vep. e cit.111

³ Jacques Baudouin, vep e cit.142

⁴ Tim Judah, Kosova: Çfarë duhet të dijë secili, Artini, (Prishtinë: 2020), 134

⁵ Marc Weller, *Shtetësia e Kontestuar*. Administrimi Ndërkombëtar i luftës së Kosovës për Pavarësi, (Prishtinë:2011), 219

ndryshim, ose në rast se negociatorët nuk e shihnin si të pranueshëm¹. Koha kur konferenca vazhdonte punimet, konflikti në Kosovë veç kishte përshkallëzuar në një luftë të përgjakshme dhe faktori ndërkombëtar frikësohej se rreziqet mund të zgjeroheshin edhe në tërë rajonin e Ballkanit². Në Konferencën e Rambujesë tre ish-in liderët që udhëhiqnin dhe ish-in ,ndërmjetësues nga Grupi i Kontaktit ishin: Christopher Hill përfaqësonte SHBA-në, Wolfgang Petritsch BE-në dhe ambasadori Boris Majorski Rusinë, qëllimi i tyre ishte që me përkushtimin më të madh gjatë punimeve të Konferencës të ofronin palët(serbët dhe shqiptarët), rreth kornizës që kishte caktuar Grupi i Kontaktit ³. Kjo Konferencë llogaritej si shkalla më e lartë e ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës e cila kishte hapur mundësitë e intervenimit të NATO-së në Kosovë⁴. Fakt shumë i rëndësishëm që duhet potencuar ishte që UÇK-ja arriti që me luftën e saj të bëhej palë e barabartë në Rambuje, dhe në aspektin diplomatik në një forme ishte gjuhëzimi serb para faktorit ndërkombëtar, Serbia ishte detyruar që të bisedonte me krerët e UÇK-së⁵. Një kontribut mjaftë të çmuar në këto momente mjaftë të vështira për Kosovën dhe popullin e saj kishin dhënë edhe miqtë tanë amerikan që me diplomatin Christopher Hill kishin arritur të unifikonin një delegacion nga ana e Kosovës, që të flisnin me një zë dhe të krijohej një ekip me një bazë sa më të gjerë dhe gjithëpërfshirëse⁶. Gazetari i njohur gjerman Erich Rathfelder në Librin e tij *Kosova Historia e Një Konflikti* , pas masakrës së Reçakut shkruante se edhe njëherë kupa ishte mbushur, pas kësaj diplomacia ndërkombëtare nuk duhej të kishte lëkundje më, ai mendonte që pas kësaj masakre edhe vet diplomacia ndërkombëtare kishte filluar të kristalizohej se çfarë vërtetë e kishte ndërmend të bënte tutje me çështjen e Kosovës⁷. Administrata në Washington⁸ vazhdonte të ishte e angazhuar në dy drejtime; një shtytje e madhe diplomatike drejt zgjidhjeve politike, po ashtu edhe përgatitjen e NATO-së nëse negociatat dështojnë, sekretarja Albright ishte më e vendosur drejt opsionit ushtarak për të mbështetur diplomacinë ⁹.

Edhe kryeministri Britanik Tony Blair potenconte në atë kohë që pas konsultimeve që kishte pasur me zyrtarët politik dhe ushtarak kishte ardhur në përfundime që zgjidhje diplomatike vështirë se do të kishte, pa veprimet ushtarake si mbështetje e diplomacisë

¹ Marc Weller, vep. e cit. 222

² Edita Tahiri, *Konferenca e Rambujesë*, Dukagjini, (Pejë:2001), 9

³ Jacques Baudouin, vep. e cit. 154

⁴ Edita Tahiri, vep. e cit. 9

⁵ Lulëzim Nika, (Prishtinë: 2019), 119

⁶ Po aty, 119

⁷ Erich Rathfelder, (Prishtinë:2023), 189

⁸ Sinani, Arsim. "Zyrtarizimi i gjuhës shqipe në përputhje me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit." *Studime Historike 03-04 (2016)*: 235-263.

⁹ James Pardew, *Paçebërësit: Lidërshipi amerikan dhe fundi i gjenocidit në Ballkan*, Koha, (Prishtinë:2020), 209

¹. Blair mendonte që perëndimi duhet të ia bënte të qartë Milosheviqit që ai nuk do të mund të bënte çfarë të donte rreth Kosovës dhe se nëse dështojnë negociatat ne do të vepronin². Nga SHBA-të nga Evropa por edhe nga NATO gjatë vitit 1998 kishte pasur mjaftë zëra që mendohej se e kërcënonin Millosheviqin për ndërhyrje të mundshme ushtarake, por si duket ende nuk shihej një presion që do të tregohej më efikas rreth intervenimit ushtarak ³. Gazetari shumë i njohur gjerman Erich Rathfelder i cili ishte shpallur person non grata nga Serbia përmend në librin e tij *Kosova Historia e një Konflikti*, që duke qenë në teren gjatë vitit 1998-1999, pasi kishte raportuar për disa masakra që kishin ndodhur në Kosovë, ishte konkludim i tij që pasi po bëhej një gjenocid ndaj shqiptarëve perëndimi duhej ta anashkalonte edhe Këshillin e Sigurimit dhe të intervenoj në shpëtimin e shqiptarëve nga gjenocidi. Ai rrëfente më tutje se një qëndrim i tillë i tij kishte shqetësuar mjaftë disa nga qarqet e partive politike te Gjermania në atë kohë. Por gazetari Erich mendonte që ata nuk kishin qenë në terren për të parë nga afër masakrat dhe realitetin që po zhvillohej në atë kohë brenda Kosove tregonte ai⁴, për të parë që intervenimi ushtarak do të behej i domosdoshëm. Wesley Clark përmend në librin e tij *Të Bësh Luftë Moderne*, që evropianët në frontin diplomatik ende ishin duke shpresuar që do arrihet marrëveshje dhe të evitohej ballafaqimi ushtarak me serbët. Të gjitha negociatat që ishin zhvilluar në Konferencën e Rambujesë qëllimin kryesor kishin të krijohej një pako gjithëpërfshirëse, të përfundonte represioni nga serbët dhe të krijohej një bazë e mirë për zgjidhje politike, duke vendosur edhe forcat e NATO-së brenda Kosovës ⁵. Është interesant fakti që gjenerali Clark përmend gjatë takimit me delegacionin shqiptar në Rambuje, ai potenconte faktin se përkundër situatës shumë të brishtë ndërkombëtare si duket këtë nuk e kuptonin si duhet delegacioni shqiptar, duke i parë si të painformuar sa duhet me situatën dhe që shprehnin kokëfortësi të madhe. Këtë ia kishte raportuar Strob Talbotit duke i thënë që shqiptarët duhet ta kuptonin pozicionin e tyre dhe çështjen se çfarë ofronte bashkësia ndërkombëtare⁶. Para përfundimit të Konferencës në Rambuje shihet qartë që ishte një involvim shumë i madh diplomatik me qëllimin e vetëm për të arritur për tu shmangur fillimi i bombardimeve. Gjatë gjithë punimeve të Konferencës në Rambuje ishin vërejtur qartë mospajtimet brenda vet Grupit të Kontaktit rreth zgjidhjes politike ,rreth asaj se cila forcë duhet të zbatonte në terren nëse veç arrihej zgjidhje, si dhe kërcënimin për përdorim të forcës për të arritur zgjidhje . Në fazat përfundimtare të konferencës edhe delegacioni jugosllavë kishte filluar të vejë në pikëpyetje edhe ato propozime që në fillim të konferencës i kishte

¹ Toni Blair, *Një Rrugëtim*, (Tiranë:2011),275

² Toni Blair, (Tiranë:2011), 277

³ Erich Rathfelder, (Prishtinë:2023),177

⁴ Po aty, 179

⁵ Wesley Clark, *Të Bësh Luftë Moderne*, Zëri, (Prishtinë:2003),199

⁶ Wesley Clark, (Prishtinë:2003), 207

parë si një kompromis i arsyeshëm ¹. Dhe mos nënshkrimi nga ana e delegacionit serb dhe nënshkrimi nga ana e delegacionit të Kosovës dihej çfarë do të thoshte kjo, pra intervenimi i NATO-së do të bëhej i pashmangshëm. Situata në terren vazhdonte të përqeshohej, vet Sekretari Solana duke parë se si forcat serbe vazhdonin të grumbulloheshin drejt Kosove gjatë marsit 1999, kishte kërkuar nga gjenerali Clark që ta telefononte Ojdaniçin gjeneralin serb që të ia bënte me dije që po shkelnin marrëveshjet e mëhershme të vitit 1998 duke sjellë forca të reja. Gjenerali serb Ojdaniq përfundimisht kishte deklaruar në telefon që po përgatitemi të mbrohem nga ju dhe ju po përgatiteni të na sulmoni ². Pra shihej që ata nuk do nënshkruanin marrëveshjen dhe situata do vazhdonte të përshkallëzohej edhe më tepër dhe intervenimi i NATO-së po bëhej i pashmangshëm, për të evituar katastrofën humanitare dhe gjenocidin që po ndodhte në Kosovë gjatë vitit 1998-1999.

Përfundimi

Si përfundim mund të konkludohet që duke parë të gjitha zhvillimet politike ndërkombëtare në raport me Kosovën dhe çështjen e saj, shihej qartë që derisa shqiptarët nuk kishin filluar luftën e armatosur çështja e Kosovës nuk ishte trajtuar seriozisht në forume dhe konferenca ndërkombëtare. Deri në konferencën e Dejtonit shqiptarët me lëvizjen paqësore kishin menduar dhe shpresuar që në këtë konferencë do të diskutohej edhe për Kosovën, por kur kjo nuk kishte ndodhur, shqiptarët e panë që duhej ndërruar strategji dhe këtë edhe e bënë duke filluar luftën e armatosur për tu çliruar nga dhuna dhe masakrat, që regjimi i Millosheviçit vazhdonte të bënte në Kosovë. Kulmi i këtyre masakrave ishin vitet 1998-1999, kjo bëri që edhe komuniteti ndërkombëtar në krye me SHBA-në të ndërmerre veprime duke shtuar aktivitetin diplomatik dhe ushtarak rreth kërimit të zgjidhjes së çështjes së Kosovës. Ky aktivitet kishte kulmuar me thirrjen e Konferencës së Rambujesë ,ku kjo do të cilësohej si niveli më i lartë i ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës. Konferenca e Rambujesë ishte një pikë kulminante ku falë luftës çlirimtare arriti që çështja e Kosovës të trajtohej më drejt dhe më seriozisht në nivelet më të larta të organizatave ndërkombëtare. Kjo konferencë bëri që pas luftës së armatosur të hapej një kapitull i ri për Kosovën dhe çlirimin e saj përfundimtarë nga Serbia. Si përfundim edhe vet shqiptarët e kuptuan se pa luftë nuk do të mund të bëheshin pjesëmarrës në Konferencat ndërkombëtare ku do të flitej edhe bëhej më tepër për zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Lufta e armatosur për çlirim ngriti në këmbë akterët relevant të politikës ndërkombëtare duke bërë që të thirrej Konferenca e Rambujesë dhe të kërkohej një zgjidhje politike sa më e pranueshme në mes Kosovës dhe Serbisë. Në fund pas shumë negociatash delegacioni i Kosovës kishte nënshkruar marrëveshjen ndërsa ai serbë jo, kjo kishte hapur mundësinë e fillimit të intervenimit të NATO-së

¹ Marc Weller, vep. e cit. 252

²Wesley Clark, (Prishtinë:2003), 203

në Kosovë në vitin 1999. Ky vit shënoj fillimin e një kapitulli të ri për Kosovën, kapitull i çlirimit përfundimtar nga pushtimi serb. Por deri te shpallja e pavarësisë në Kosovë nga viti 1999 do të vendosej administrimi i përkohshëm ndërkombëtar nga OKB-ja (UNMIK), kur tek në vitin 2008 Kosova do të shpall pavarësinë e saj.

Literatura

- Buxhovi Jusuf, Kosova 1999-2001, Faik Konica, Prishtinë, 2018
Edita Tahiri, Konferenca e Rambujesë, Dukagjini, Pejë, 2001
Erich Rathfelder , Historia e Një Konflikti, Koha, Prishtinë,2023
Halim Bajraktari, Roli dhe Prespektiva Europiane e Kosovës, punim doktrature, Universiteti i Tiranës,Tiranë, 2014
Jacques Baudoin, Lindja e Një Demokracie: Hashim Thaçi dhe Rruga drejt Kosovës së Pavarur 1987-2008, Prishtinë, Buzuku, 2018
James Pardew, Paçebërësit - Lidërshipi amerikan dhe fundi i gjenocidit në Ballkan, Koha, Prishtinë, 2021
Joscha Fischer, Vitet kuq-gjellbër, Politika e Jashtme gjermane nga Kosova e deri më 11 shtator, Koha, Prishtinë,2007
Lulzim Nika, Diplomacia Ndërkombëtare dhe Çështja e Kosovës 1997-1999,punim doktrature, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2019
Marc Weller, Shtetësia e Kontestuar: Administrimi Ndërkombëtar i luftës së Kosovës për Pavarësi, Prishtinë, 2011
Martti Ahtisaari, Detyra në Beograd, Trend, htinë,2008
Sinani, Arsim,. Zyrtarizimi i gjuhës shqipe në përputhje me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit. Studime Historike 03-04 (2016): 235-263.
Tim Judah, Kosova: Çfarë duhet të dijë secili, Artini, (Prishtinë:2020
Tony Blair, Një rrugëtim, Tiranë,2011
Wesley Clark, Të Bësh Luftë Moderne, zëri, Prishtinë, 2003.